

ANËSIA

EPISTEMOLOGJIKE

NË SHKENCAT FIZIKE DHE SOCIALE



**EPISTEMOLOGICAL  
BIAS**

*in the Physical & Social Sciences*

**Edited By: Abdelwahab M. Elmessiri**

THE INTERNATIONAL INSTITUTE OF ISLAMIC THOUGHT

Seria e Librave të Shkurtër INMI

ANËSIA  
EPISTEMOLOGJIKE  
NË SHKENCAT FIZIKE DHE SOCIALE

Abdelwahab M. El-Messiri

Anësia epistemologjike në shkencat fizike dhe sociale (botim i shkurtuar)

Titulli origjinal

*Epistemological Bias in the Physical and Social Sciences* (Abridged edition), The International Institute of Islamic Thought, 2013.

Copyright © 2013 The International Institute of Islamic Thought

Botimi i parë në gjuhën shqipe. Copyright © 2018 Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC)

**ISBN 978-9928-126-18-4**

Ky libër është e drejtë e autorit. Në varësi të përjashtimit ligjor dhe në dispozitat e marrëveshjeve përkatëse të licencimit kolektiv, asnjë riprodhim i asnjë pjese nuk mund të bëhet pa lejen me shkrim të botuesve.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë libër janë ato të autorit dhe jo medoemos ato të botuesve.


**Përkthimi:** Festime Mehdiu

**Botues:** Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, [www.aiitc.net](http://www.aiitc.net)

**Redaktor:** Nexhatin Ibrahimimi | **Redaktor teknik:** Suhejb Xhemali

**Shtypi:** Mileniumi i Ri | Tiranë, 2018

Abdelwahab M. El-Messiri



**ANËSIA**  
**EPISTEMOLOGJIKE**  
**NË SHKENCAT FIZIKE DHE SOCIALE**

Përkthimi:  
Festime Mehdiu



Tiranë, 2018



Botimi i këtij libri u mbështet nga Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).



# PËRMBAJTJA

SERIA E LIBRAVE TË SHKURTËR TË INMI.....	7
HYRJE .....	9
KAPITULLI I	
PORTA E IXHTIHADIT: HYRJE NË STUDIMIN E ANËSISË EPISTEMOLOGJIKE.....	13
KAPITULLI II	
ANËSIA NË SHKOLLAT PERËNDIMORE TË MENDIMIT: TRASHËGIMIA JONË SI PIKËNISJE PËR ZHVILLIM.....	17
KAPITULLI III	
TEORITË E ZHVILLIMIT POLITIK: NJË RAST I DISKURISIT TË NJËANSHËM NË SHKENCAT POLITIKE .....	20
KAPITULLI IV	
MODERNIZIMI VS. PERËNDIMIZIMI I SHKENCAVE SOCIALE: RASTI I PSIKOLOGJISË.....	24
KAPITULLI V	
ANËSIA NË KURRIKULA DHE PËRMBAJTJE TË LËNDËVE .....	28
KAPITULLI VI	
NJË EKSPLOKIM I NATYRËS SË NJERIUT DHE INTELIGJENCËS ARTIFICIALE DHE PERSPEKTIVA KURANORE .....	31

KAPITULLI VII	
PËRBALLJA ME ANËSINË NË KULTURËN E BOTËS SË TRETË.....	35
KAPITULLI VIII	
PËRTEJ METODOLOGJISË: FORMAT E ANËSISË NË KRITIKËN LETRARE PERËNDIMORE.....	38
KAPITULLI IX	
TEORITË DHE PRAKTIKAT E DIZAJNIT NË ARKITEKTURËN E SHOQËRIVE ISLAME: NJË QASJE CEREMONIALE NË NDËRTIMIN E KOMUNITETIT .....	42
KAPITULLI X	
REFLEKTIMET NË TEKNOLOGJI DHE ZHVILLIM: NJË PERSPEKTIVË KULTURORE .....	44
KAPITULLI XI	
BESIMET THEMELORE FILOZOFIKE PËR FORMULIMIN E LIGJEVE FIZIKE .....	47
REDAKTORI .....	50



## SERIA E LIBRAVE TË SHKURTËR TË INMI

Seria e Librave të Shkurtër të INMI është një koleksion i vlefshëm i botimeve kryesore të Institutit, i shkruar në formë të kondensuar për t'u dhënë lexuesve një kuptim thelbësor të përmbajtjes kryesore të originalit. Prodhuar në një format të shkurtër, të lehtë për t'u lexuar, format që kursen kohë, këto përmbledhje ofrojnë një përmbledhje të ngushtë, të shkruar me kujdes të publikimit më të madh dhe shpresohet t'i stimulojë lexuesit në eksplorimin e mëtejshëm të origjinalit.

*Anësia epistemologjike në shkencat fizike dhe sociale*, me redaktor dhe autor të shkrimit të parë El-Messirin, është një antologji e shkrimeve mbi temën e Anësisë, botuar fillimisht në arabisht nga INMI dhe më pas përkthyer në anglisht. Ky version i Librave të Shkurtër është një botim i shkurtuar i përkthimit në anglisht.

Koleksioni i punimeve që përbëjnë antologjinë, shqyrton dhe kritikon një çështje të pranuar gjerësisht në botën akademike muslimane, si një aspekt thelbësor dhe përcaktues i njohurive akademike, pavarësisht se është një filozofi perëndimore e shkencës dhe e mendimit. Ky është dominim i pozitivizmit filozofik dhe një adoptim i afërt si dhe pranim i padiskutueshëm i paradigmave, terminologjive dhe modeleve të kërkimit që janë,



në të vërtetë, të huaja ndaj realiteteve socio-ekonomike dhe fetare të botës muslimane. Pra, sa i besueshëm është aplikimi dhe qëndrueshmëria e tyre? Për El-Messirin, çështja e anësisë në metodologji dhe terminologji është një problem që përballet me hulumtuesit në lindje, në perëndim, në veri dhe në jug. Megjithatë, ajo përballet me intelektualët e Botës së Tretë me një prirje të veçantë, sepse, edhe pse shkruajnë në një mjedis kulturor që ka paradigmat e veta konceptuale dhe kulturore, ata ndeshen me një paradigmë të huaj që përpiket të imponojë veten në shoqërinë, imagjinatën dhe mendimet e tyre. Pse të mos krijojmë një shkencë të re, të përshtatshme për qëllimin, me mekanizmat e tij, metodologjitë dhe pikat e referencës për të trajtuar paragjykimet epistemologjike dhe për të hapur portën e *ixhtihadit* për ata?

Punimet synojnë të zbulojnë disa nga paragjykimet latente në terminologjinë, metodologjitë, mjetet e hulumtimit dhe parimet tona konceptuale, si dhe të propozojmë alternativa të shënuara nga një shkallë më e lartë e pavarësisë dhe neutralitetit. Kjo nuk është për të pakësuar vlerën njerëzore të kontributeve krijuese të Perëndimit, por për të theksuar rrezikun që ta bëjmë atë pikë referimi përfundimtare dhe pastaj të përpiqemi vazhdimisht të luajmë 'të arrijmë' me të.

**Botim i Shkurtër i Originalit** *Anësia epistemologjike në shkencat fizike dhe sociale*, Redaktuar nga Abdelwahab M.

El-Messiri

ISBN hbk: 1-56564-417-4

ISBN pbk: 1-56564-416-6

2006



## HYRJE

Ky libër shqyrton një çështje akademike të rëndësishme, por të lënë pas dore: adoptimin e gjerë dhe pranimin e paradigmave, terminologjive dhe modeleve kërkimore të huaja ndaj realiteteve socio-ekonomike-fetare të botës muslimane. Hulumtuesit kudo përballen me çështjen e anësisë në metodologji dhe terminologji, por ky problem është i ngutshëm sidomos në mesin e intelektualëve të Botës së Tretë. Megjithëse shkruajnë në mjedise kulturore me paradigmat e tyre specifike konceptuale dhe kulturore, ata gjithashtu ndeshen me një paradigmë të huaj (perëndimore) që përshkon shoqëritë e tyre dhe proceset e mendimit.

Këto paradigma kanë përparësi në fushat ekonomike dhe politike të Perëndimit, por jo gjithmonë lidhen me realitetin e popujve joperëndimorë dhe prandaj mund të kenë një efekt shtrembërues. Studiuesit që braktisin paradigmat indigjene dhe paragjykimet e situatave të tyre të veçanta ekzistenciale dhe historike miratojnë paradigma perëndimore në këtë proces dhe fillojnë të shikojnë veten nga një këndvështrim perëndimor, madje edhe kur është i anshëm ndaj tyre. Çdo komunitet kërcënohet kur i pranon paradigmat dhe pikëpamjet e importuara, ndonjëherë pa njohuri të thella të rrjedhëve epistemologjike të paradigmave të tilla.

Me ngritjen e mendimit nacionalist arab, debati për identitetin dhe specifikat kulturore është intensifikuar, por pa një studim gjithëpërfshirës dhe metodologjik. Mungesa aktuale e neutralitetit në shkencat shoqërore arabe mund të përmirësohet duke krijuar një shkencë të re me mekanizmat, metodologjitë dhe pikat e veta të referencës për të adresuar anësitë epistemologjike dhe për të ftuar *ixhtihadin*<sup>1</sup> ose interpretimin.

Anësia është kombinimi i vlerave latente që bazojnë një paradigmë dhe procedurat dhe metodologjitë që drejtojnë kërkuesit. Këto vlera, nganjëherë në formë të modeleve ose metaforave konceptuale, lidhen gjithashtu me metodologjitë e hulumtimit dhe janë shumë të vështira për t'u ndarë. "Progresi i referohet një metafore që krahason lëvizjen e historisë me një vijë të drejtë që çon në një pikë të caktuar, kundrejt ciklicitetit. Shumë metafora epistemologjike të nënkuptuara vijnë të njëanshme dhe të gatshme nga Perëndimi dhe kufizojnë lirinë e kërkimit dhe të mendimit. Në identifikimin dhe adresimin e anësisë epistemologjike ne mund të krijojmë një paradigmë alternative. Studimet e rastit të këtij libri adresojnë këtë çështje dhe eksplorojnë anësinë latente në një fushë të caktuar; citojnë shembuj specifikë; shpjegojnë se si këto anësi punojnë dhe orientojnë hulumtimin; dhe citojnë shembuj që janë anashkalluar për shkak të paragjykitimit të modelit mbizotërues dhe që mund të vërehet vetëm nëpërmjet një metodologjie të re që shpreh një paradigmë të re.

Në këto studime autorët do të përshkruanin paragjykimet e tyre dhe do të propozonin alternativa në përpjekje për të rritur hetimin lidhur me kulturën perëndimore dhe paradigmat epistemologjike të saj. Këto paradigma alternative nuk do të zëvendësonin medoemos paradigmat e përhapura, por do të funksiononin si

---

1 *Ixhtihad* (arabisht: "përpjekje"): Në ligjin islam nënkupton arsyetimin e pavarur juridik të problemeve që nuk mbuloohen saktësisht nga Kurani, hadithi dhe konsensusi i dijetarëve të Islamit. (shën. i red)

mjete më komplekse për të studiuar shoqëritë arabe / muslimane. Gjithashtu, shpresohet se paradigmat e reja do t'i pasurojnë ato mbizotëruese dhe do t'i zgjerojnë parametrat e tyre, duke i transformuar ato nga paradigma të mbyllura, bazuar në supozimet moderne perëndimore, në paradigma universale të hapura. Një paradigmë arabe/muslimane e pavarur nuk do të nënkuptonte mohimin e vlerave kulturore perëndimore. Paradigma e re mund t'i zgjerojë parametrat e konceptit të përparimit, ose të heqë dorë nga ajo krejtësisht. Një metodë më komplekse dhe objektive e vëzhgimit mund të zhvillohet dhe të trajtojë problemin e përdorimit të metodologjive dhe mjeteve subjektive nga Perëndimi për hulumtuesit arabë.

Ky libër kërkon të theksojë karakterin krijues, revolucionar të anësisë kundërshtuese dhe të ndihmojë lexuesit ta njohin dhe kapërcejnë atë. Shpresojmë se shkenca (*fikhu*) e anësisë do të kontribuojë në mbrojtjen e specifikës dhe të veçantës, të njeriut kundër dekonstruktives, abstraktes, të përgjithshmes dhe jo njerëzores.





## KAPITULLI I

### PORTA E IXHTIHADIT: HYRJE NË STUDIMIN E ANËSISË EPISTEMOLOGJIKE

*Abdelwahab El-Messiri*

Jeta njerëzore përbëhet nga gjeste, vepra, sjellje, incidente dhe mijëra veprime të tjera të mira. Përveç funksioneve të pavullnetshme si frymëmarrja, çdo veprim është rezultat i rëndësishëm i një zgjedhjeje të ndërgjegjshme ose të pavetëdijshme dhe pasqyron kulturën e perceptimet e një personi. Përmes syve të një shoqërie ose përmes një individi, për shembull, humbja e brendshme mund të transformojë gjithçka në një shenjë rënije, ndërsa për një shoqëri ose individ tjetër, fitorja e brendshme transformon të njëjtat objekte në shenja të triumfit. Një shembull i tillë tregon kuptimin dhe kontrastin e anësisë.

Çdo sjellje njerëzore është domethënëse në aspektin kulturor dhe përfaqëson disa paradigma e perspektiva epistemologjike. Një paradigmë është një foto abstrakte mendore, një koncept imagjinar dhe një përfaqësim simbolik i realitetit që rrjedh

nga rindërtimi dhe dekonstrukcioni mendor. Mendja mbledh disa karakteristika nga realiteti, duke refuzuar disa dhe duke mbajtur të tjerat, duke i riorganizuar ato sipas përparësisë dhe duke ia korresponduar realitetit. Paradigma mund t'i ekzagjerojë ato elemente që i konsideron thelbësore dhe t'i nënvleftësojë të gjitha të tjerat. Secila paradigmë është epistemologjike me kriteret, besimet, hipotezat dhe përgjigjet e saj themelore.

Anësia, mbrojtja e një pikëpamjeje të veçantë, shoqërohet me mendjen selektive njerëzore dhe procesin e saj të perceptimit. Anësia është e integruar në mënyrë organike me gjuhën dhe kulturën dhe është specifike për gjuhët, duke e bërë gjuhën një mjet të njëanshëm. Anësia është e pashmangshme dhe rrjedh nga unikaliteti njerëzor dhe liria e zgjedhjes. Pavarësisht nga kufijtë e saj, gjuha njerëzore mund të arrijë një komunikim të suksesshëm për të kapërcyer anësitë dhe për të ndërtuar paradigma epistemologjike edhe pse ato dalin nga një eksperiencë e veçantë kulturore.

Disa anësi janë të qarta dhe të vetëdijshme, ndërsa të tjerat janë të nënkuptuara dhe të pavetëdijshme. Anësia e pavetëdijshme ndodh kur dikush përbrendëson një sistem epistemologjik me premisat dhe prioritetet e tij dhe pa e kuptuar botën vetëm nëpërmjet saj. Anësia shfaqet në shumë forma të tjera dhe nuk është gjithmonë logjike në manifestimin e saj.

Anësia drejt paradigmës kulturore perëndimore është një nga format më të përhapura të paragjykimeve në mbarë botën. Ata që braktisën trashëgiminë tonë e bënë kështu pa e kuptuar implikimin e kësaj sjelljeje dhe pa ndonjë studim kritik krijues për çdo trashëgimi dhe kulturë. Bota Islame, e cila hyri në një konflikt të hidhur me këtë formacion kulturor që nga fillimi, u nda përfundimisht në mes të fuqive imperialiste perëndimore. Kohët e fundit, afrimi me Perëndimin ka motivuar të gjitha të ashtuquajturat projekte ringjalljeje në "Botën e Tretë", duke përfshirë edhe botën islame. Kjo mund të shihet më qartë në

mendimin liberal laik, ku “Rilindja” nënkupton kryesisht importimin e mendimeve dhe teorive perëndimore dhe adoptimin e paradigmeve kulturore perëndimore. Shoqëritë arabe dhe muslimane, pra, duhet të “reformoheshin” për të përmbushur standartet e kësaj paradigme.

Këto përpjekje me kalimin e kohës kanë shkaktuar anim midis intelektualëve arabë për trashëgiminë perëndimore dhe shpërfilljen e trashëgimisë së tyre. Njerëz të tillë të arsimuar zënë zyra të rëndësishme dhe janë të rrezikshëm, sepse riformojnë sistemin e vlerave përgjatë vijave perëndimore dhe përhapin paradigmen. Një paradigme kulturore zakonisht mishëron një paradigme të plotë njohëse që përmban një sistem vlerash. Paradigma moderne perëndimore, e cila është utilitariste dhe racionaliste-materialiste, nënkupton shembuj të tillë dhe shumicën e njohurive, shkencave dhe qëndrimeve njerëzore. Ajo manifestohet në terminologjinë, aksiomat, metodat e hulumtimit dhe procedurat njerëzore. Kjo paradigme materialiste është më dominuese, sepse imperializmi perëndimor ka internacionalizuar paradigmen e vet kulturore dhe e imponon atë në shoqëri të shumta, duke shkaktuar keqkuptimin se paradigma perëndimore është universale.

Kjo paradigme bazohet në supozimet e centristëve rreth një universi që është i brendshëm, jo i jashtëzakonshëm. Së dyti, fenomenet njerëzore dhe natyrore formojnë një tërësi të vazhdueshme, të njëjtat ligje që zbatohen për të dyja në shkallë të barabartë. Qeniet njerëzore janë kështu një pjesë e pandashme e rendit natyror material. Kjo pikëpamje prodhon anësi ndaj materiales dhe natyrës në kurriz të jomateriales dhe njerëzores, si dhe ndaj të dukshmes, të matshmes dhe sasiores kundër papërsosmërisë, cilësore dhe çdo gjëje që nuk mund të matet. Shoqëritë perëndimore konsiderohen kulmi i këtij procesi universal, evolucionar, unitar dhe natyror dhe prandaj janë një model që imitohet. Megjithatë, shumë supozime të tilla janë provuar të



pavlefshme. Është zbuluar se burimet natyrore janë të kufizuara dhe mendja njerëzore është e kufizuar.

Disa mekanizma mund të na ndihmojnë të kapërcejmë anshmëritë e tilla. Të diturit se anësia është e pashmangshme është hapi i parë drejt tejkalimit të saj. Përpjekjet tona teorike për të zbuluar anësitë duhet të përfshijnë të gjithë strukturën teorike të filozofisë perëndimore. Një pikëpamje më radikale, komplekse dhe gjithëpërfshirëse duhet të bazohet në supozimin se nuk ekziston asnjë kurs i vetëm historik ose kulturor. Ne duhet të jemi të hapur për qytetërime të ndryshme botërore dhe të përfitojmë nga traditat e tyre kulturore dhe intelektuale që mund të thellojnë kuptimin tonë të njerëzimit, shoqërisë dhe natyrës. Ndërsa për të eliminuar anësitë duhet të formojmë një paradigmë alternative që përfiton nga të gjitha përvojat e mëparshme njerëzore, duke mos përjashtuar Perëndimin.

Një paradigmë e propozuar alternative dhe qasje shkencore do të rridhte nga trashëgimia jonë islame vendëse; të punojmë drejt një teorie gjithëpërfshirëse; të fillojmë nga dija se njerëzit zënë një pozicion qendror në univers; të përfshijmë një kategori jomaterialiste; të operojmë në një mënyrë prodhuese (jo-grumbulluese); dhe të lejojmë siguri jo të plotë dhe ixtihad të vazhdueshëm.



## KAPITULLI II

### ANËSIA NË SHKOLLAT PERËNDIMORE TË MENDIMIT: TRASHËGIMIA JONË SI PIKËNISJE PËR ZHVILLIM

*Adel Hussein*

Bota arabe dhe muslimane ka hyrë në një fazë të rishikimit kritik të koncepteve dhe qëndrimeve tona tradicionale në nivelet intelektuale dhe teorike. Shkencat shoqërore u mbështetën mjaft gjatë në teoritë e aksioneve që penguan studiuesit tanë të formulonin vëzhgimet e tyre kritike përmes praktikës. Në sferën epistemologjike, mbizotërimi i nocioneve të iluminizmit do të thoshte “laicizëm” i mbizotëruar në çështjet sociale. Qasja perëndimore kishte për qëllim bashkimin e shkencave shoqërore dhe natyrore dhe ne në Lindje e adoptuam të njëjtën qasje. Megjithatë, për shkencat sociale që të fitojnë legjitimitetin dhe njohjen akademike si objektive, universale, të besueshme dhe shkencore, ato duhet të bazohen në njohuri solide të bazuara në të gjitha shoqëritë njerëzore dhe historitë e tyre përkatëse.

Në fushën e kufizuar (perëndimore) të shkencave sociale, modelet teorike kryesisht u përqendruan në konfliktin midis

punës e kapitalit dhe koncepteve laike e ideve të progresit materialist. Në fakt, problemet e sfidat me të cilat ballafaqohet civilizimi perëndimor në epokën bashkëkohore nuk mund të gjejnë më zgjidhje në nivelet shoqërore dhe ekonomike të qytetërimit perëndimor, një fenomen që ende nuk është studiuar dhe analizuar plotësisht. Ne përballemi me pyetje dhe sfida të ndryshme nga ata që janë në përvojën perëndimore dhe kërkojnë zhvillimin e shkollave të mendimeve dhe metodologjive të ndryshme.

Gjatë dy shekujve të fundit, teza standarde ka qenë se shkencë klasike është fillimisht evropiane, që buron drejtpërdrejt nga filozofia dhe shkencë greke. Diskursi ekonomik justifikon një fuqi superiore mbi botën, e cila pastaj bëhet e varur ekonomikisht nga një ndarje ndërkombëtare e punës. Të gjitha format e organizimit shoqëror dhe menaxhimit politik jashtë Perëndimit konsiderohen inferiore dhe të paafta për ripërtëritje dhe zhvillim. Kjo dogmë që rezultoi e justifikoi imperializmin dhe hegjemoninë perëndimore në format e saj më të këqija.

Praktikanët e pavarur të shkencave shoqërore në shoqëritë tona lindore janë gjithnjë e më të kujdesshëm për importimin e varësisë intelektuale në teorinë sociale perëndimore. Kjo pikëpamje kritike është përforcuar nga zbulimi i anësisë dhe paragjyqimit të studimeve perëndimore lidhur me historinë dhe trashëgiminë tonë. Shumë studime empirike tregojnë vlerën reale të arritjeve tona dhe kanë identifikuar disa karakteristika specifike të rrjedhës së historisë sonë. Një praktikë e pavarur teorike, që mbështetet në rezultatet empirike dhe mbështetet nga një qasje kritike e përgjithshme, është e parapëlqyeshme.

Shkollat perëndimore të mendimit konfirmuan se qeniet njerëzore janë nga natyra e botës (laike) dhe e vendosin vetë interesin fizik mbi çdo konsideratë tjetër. Ky këndvështrim thekson zhvillimin teknologjik dhe industrial si një mënyrë për të kënaqur këtë interes vetjak materialist. Në këtë proces, ne nuk i hedhim poshtë disa konstruksione teorike perëndimore, por

duhet të zgjidhim atë që është perëndimore, çfarë është universale dhe çfarë është në përputhje me doktrinën tonë të vlerës. Shumë koncepte të tilla, për shembull, kanë të bëjnë me laicizmin dhe mund të mos jenë të qëndrueshme në shoqërinë dhe sistemin tonë ekonomik. Ndikimi thelbësor i shoqërisë sonë dhe pika përfundimtare e referimit vjen kryesisht nga Islami. Formulimi i së ardhmes nën ndikimin e Islamit dhe trashëgiminë e tij kulturore është përgjegjësi e teorizimit të pavarur ose fikih dhe ixhtihad bashkëkohor.

Për vendet në zhvillim, vetëbesimi në trajtimin e kombeve dominuese është vlera më e rëndësishme në zhvillimin e pavarur ekonomik dhe kulturor. Adoptimi dhe zbatimi serioz i këtij qëllimi do të thotë një revolucion radikal në të gjitha aspektet e jetës. Politikatat e zhvillimit duhet të jenë të strukturuar për të përballuar këtë proces.

Një strategji e përgjithshme e plotësimit të nevojave themelore me qëllimin përfundimtar të pavarësisë mund të integrojë gjashtë parimet e mëposhtme: marrëdhëniet me botën e jashtme, vetë-mbështetjen, rolin e shtetit në mbështetjen e pavarësisë, strategjinë e suficitit ekonomik në maksimizimin, shpërndarjen dhe zhvillimin si një proces kompleks. Ana sociale e zhvillimit mbështetet në mobilizimin e masave. Mjetet tona kryesore të realizimit të këtij zhvillimi të pavarur janë nëpërmjet një koncepti të veprimit shoqëror që kërkon të mobilizojë energji të ndryshme dhe konkurruese brenda një shoqërie të veçantë nacionale nëpërmjet institucioneve të përshtatshme.

Revolucionet e mëdha zakonisht nxiten nga një doktrinë e fortë kurse Islami, në veçanti, mishëron një doktrinë të tillë. Modeli i pavarësisë nënkupton një konfrontim të pandërprerë me fuqitë e mëdha në frontet kulturore, politike dhe ekonomike, por modeli në vend të kësaj, mishëron një luftë të vogël kundër interesave që dalin rrënjësisht kundër vetes sonë.



## KAPITULLI III

### TEORITË E ZHVILLIMIT POLITIK: NJË RAST I DISKURISIT TË NJËANSHËM NË SHKENCAT POLITIKE

*Nasr M. Arif*

Çdo punë akademike është shprehëse e kulturës së shoqërisë në të cilën mendimi i autorit të saj është formësuar dhe informuar. Prandaj, shkëputja e plotë nuk mund të arrihet. Të dhënat epistemologjike lidhen me kohën dhe vendin. Vetëqëndërimi është thelbësor për anësinë dhe për vlerësimin e Tjetrit sipas kriterëve të vetëvendosjes. Teoritë e zhvillimit politik që konsiderohen thelbi i konceptit të zhvillimit përfshijnë të gjitha teoritë relevante në sferat e zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor. Analiza e mëposhtme do të trajtojë bazat metodologjike dhe filozofike të shumicës së teorive të zhvillimit në shkencat sociale. Koncepti i zhvillimit politik dhe rrënjët e tij mund të përdoren për të parë nëse anësia i ka bërë këto teori të pjesshme dhe ekskluzive ose nëse këto teori janë universale dhe të zbatueshme për shumicën e shoqërive njerëzore pavarësisht nga dallimet e tyre.

Shkenca karakterizohet nga studimi i fenomeneve specifike njerëzore ose natyrore, pavarësisht nga detajet e tyre ose nga vendet gjeografike. Sipas mendimit perëndimor, shkenca është një aktivitet intelektual që merret me gjendjen reale dhe objektive të gjërave. Një shqyrtim i afërt i origjinës dhe zhvillimit të shkencave shoqërore perëndimore dhe shkencave humane zbulon se ata i konsiderojnë shkencat e tyre si qasjet më të mira për të kuptuar dhe kontrolluar realitetin njerëzor. Që nga Rilindja, një prirje akademike gjithnjë në rritje është përqendruar në studimin e “shoqërive jo-perëndimore”. Qëllimi i këtyre studimeve mund të ketë qenë akademik, por disiplinat e tyre ende janë me të meta dhe nuk kanë prodhim krijues shkencor, pavarësisht nga zhvillimi në mjetet, metodologjinë dhe diskursin e shkencave sociale perëndimore.

Disa shkenca që i përkushtohen studimit të shoqërive joperëndimore mund të kenë synuar të shkëputin Perëndimin nga Lindja, në mënyrë që përfundimisht ta kontrollojnë atë. Antropologjia kërkonte të kontrollonte botën joperëndimore dhe të shkatërronte kulturën dhe qytetërimin e saj me qëllim të aneksimit të saj në kulturën perëndimore. Teoritë e zhvillimit kulturor dhe socio-politik përputhen me objektivat politike prapa të gjitha teorive të tjera të shkencave perëndimore të përkushtuara për studimin e botës joperëndimore. Orientalizmi u ngrit kur “Tjetra” në mënyrë specifike nënkuptonte Islamin apo Lindjen fetare. Në periudhën pas koloniale, një model i ri i dominimit e përforcoi Perëndimin si modelin ideal njerëzor dhe social që do të ndiqej nga shoqëri të tjera. Akademia e besueshme nuk mund të studiojë ato shoqëri me të njëjtat kategori analitike të përdorura në studimin e shoqërive perëndimore; përkundrazi, shkencat e pavarura janë të nevojshme për studimin e shoqërive të tilla.

Modeli shoqëror perëndimor projekton pikëpamjen e thjeshtë etnike që redukton njerëzimin tek “ata” dhe “ne”. Kjo qasje ka çuar në nxjerrjen e koncepteve të paqarta që preten-

donin se përfaqësonin ato shoqëri “të tjera”, pa kritere efektive ose pa bazë për analizë. Ata që përcaktojnë “Lindjen” në këtë mënyrë rrezikojnë një thjeshtim të rëndë të një numri të civilizimeve dhe kulturave të ndryshme. Koncepte të tjera merreshin me Tjetrën, duke e përshkruar atë si të prapambetur, primitive, bujqësore, joundustrial dhe Botë të Tretë. Vendet në studim nuk kanë pothuajse asnjë marrëdhënie historike ose kulturore dhe në vend të kësaj janë kategorizuar me forcë nga Perëndimi si një, pavarësisht nga diversiteti i tyre i brendshëm.

Që nga dalja e orientalizmit, mendimtarët perëndimorë kanë projektuar në mënyrë të ndërgjegjshme ose të pandërgjegjshme përvojën e shoqërive të tyre në botën joperëndimore, duke e klasifikuar historinë në një kohë të lashtë, mesjetare dhe moderne, duke promovuar konceptin e shtetit të shkencave politike perëndimore, duke parë një zhvillim linear të shoqërive njerëzore përgjatë fazave ngjitëse dhe duke projektuar ideale e objektiva perëndimore mbi modelet e tjera njerëzore. Kjo anësi e vetëqendërimit heq tjetrin nga e drejta për të ekzistuar dhe përpiket ta dëbojë atë nga kuadri i shkencës apo historisë. Shkenca e njëanshme imponon kategoritë, konceptet dhe metodat e veta. Nëse marrim parasysh literaturën e zhvillimit politik në përgjithësi, shohim se procesi i mohimit dhe zëvendësimit e thekson mohimin e kulturës, institucioneve dhe ekonomisë tradicionale, duke i zëvendësuar ato me kulturën, institucionet dhe ekonominë moderne.

Anësia shpesh përcakton metodën e analizës, mënyrat e interpretimit dhe gjetjet e hulumtimit akademik. Si i tillë, hulumtuesi i paanshëm nuk mund të përcaktojë anësinë, për më tepër të neutralizojë ose të largojë efektet e saj. Përkufizimi dhe neutralizimi i anësisë duhet të përbëjë dy metoda themelore të trajtimit të fenomeneve socio-politike. Përcaktimi i anësisë në teoritë e zhvillimit politik është thelbi i ndryshimit dhe evolucionit shoqëror dhe ky proces kërkon një qasje metodologjike.

Nëse hulumtuesi zbaton këto qasje, hapi tjetër është neutralizimi i anësisë në studimet e tij / saj. Mbetet një faktor bazë që mund të kontrollohet vetëm duke mësuar etikën e studiuesit dhe nxënësit, sepse kërkimet shkencore duhet të bazohen në ndershmërinë morale dhe në respektimin e kritereve të drejtësisë.





## KAPITULLI IV

### MODERNIZIMI VS. PERËNDIMIZIMI I SHKENCAVE SOCIALE: RASTI I PSIKOLOGJISË

*Rafik Habib*

Komunitetet kudo punojnë për të rritur performancën e tyre teknologjike dhe aktivitetet shkencore, por theksojnë performancën më shumë sesa testimin e koncepteve dhe metodave shkencore. Vendet e Botës së Tretë përdorin shkencën për të matur nivelin e progresit dhe dëshira e muslimanëve për progres arrihet duke thithur dhe / ose duke imituar modelet shkencore të përhapura në komunitete të tjera më të avancuara. Paradigma shkencore e adoptuar nga vendet e përparuara fiton legjitimitet dhe rëndësi nga aftësia e saj për të modifikuar mjedisin në një mënyrë të pranueshme për njerëzit që jetojnë në ato pjesë të botës. Në botën arabe dhe në vende të tjera, njerëzit i importojnë risitë shkencore në jetën e tyre së bashku me stilin e jetës dhe idealet që i shoqërojnë, duke rritur kështu nevojën për më shumë teknologji të importuar.

Shkenca nuk duhet të merret si një qëllim në vetvete, por si një mjet për të përmirësuar cilësinë e jetës, duke modifikuar mjedisin.

Imitimi kurrë nuk mund të kalojë për një arritje origjinale. Vendet muslimane kanë qenë në gjendje të importojnë aspektet formale dhe të aplikuara të shkencës moderne, por jo rolin pozitiv shoqëror të saj. Kopjimit të të tjerëve i mungon një aspekt thelbësor i progresit të vërtetë: aftësia për të zhvilluar modele të reja të shkencës dhe modelet e jetës që pasqyrojnë identitetin kulturor musliman.

Përparimi i vërtetë në filozofinë dhe teologjinë perëndimore nuk e ka fituar momentin, derisa Perëndimi e mësoi të rritë mendimin arab. Përkundrazi, bota arabe sot nuk e ka tejkaluar frikën e mendimeve dhe kulturave të vendeve të tjera. Ky obsesion me *të Tjerët* ka tejkaluar mirëpritjen dhe faza imituese është bërë joefektive, duke shërbyer vetëm për të zgjatur dhe për të përforcuar gjendjen aktuale të prapambetjes. Bota muslimane ka pranuar me vetëdije shumë koncepte dhe vlera të huaja gjatë një periudhe të gjatë, duke e dëmtuar identitetin e vet dhe duke humbur kritere të sinqerta për gjykimin e shëndoshë.

Shkenca importohet dhe konsumohet si çdo mall tjetër dhe këto pika zbatohen njësoj edhe për shkencat shoqërore. Përderisa njohuria për faktet fizike dhe kimike mund të transmetohet në mënyrë të sigurt nga një komunitet në tjetrin, dija për faktet shoqërore nuk mundet. Miratimi dhe zbatimi i njohurive të huaja nënkupton miratimin e një jetese të tërë dhe të një realiteti shoqëror jo të rrënjosur në shoqërinë indigjene. Me shkencën shoqërore, rreziku është i komplikuar, sepse vendet muslimane kopjojnë funksionet dhe aplikimet e njohurive shkencore, si dhe të gjithë korpusin e njohurive. Gjetjet e hulumtimit psikologjik dhe sociologjik humbasin rëndësinë e tyre, kur transportohen nëpër kufinj.

Do të ishte më e rëndësishme të merreshin në konsideratë konceptet ose kriteret e përdorura për hulumtime, në vend që t'i pranojnë ato si objektive dhe pa anësi kulturore. Fanatizmi ekzistues rreth natyrës utopike të objektivitetit shkencor i nënshtrohet çdo përpjekjeje për të krijuar një qasje specifike arabe në shkencë për kritika serioze. Shkenca shoqërore lehtë mund të bëhet një mjet efektiv për përforcimin e varësisë kulturore, sjelljes dhe moralit.

Veçanërisht në Botën e Tretë, adoptimi i modelit amerikan rezulton në përforcimin e vlerave amerikane në mesin e komuniteteve në zhvillim. Aty ku publiciteti i medias dhe dominimi ekonomik mund të dështojnë, një program transmetimi i aplikimit shkencor mund të ketë sukses. Rezultati është një imazh i shtrembëruar i një shoqërie të disintegruar individualiste që nuk ka konkurrencë, iniciativë dhe produktivitet.

Sipas pikëpamjes së Mohammad Shakroun, individi arab është një qenie "kolektive", ndërsa shkenca e importuar përpiqet t'i kthejë arabët në individë që përpiqen të konkurrojnë. Kjo krijon një dilemë që i detyron arabët ta braktisin "kolektivitetin" e tyre në dobi të një individualizmi të importuar. Nga ana tjetër, një qasje radikale empirike mund t'i afrohet çdo shoqërie sipas tendencës dhe normave intelektuale dhe kulturore, vlerave dhe gjykimeve etike të saj.

Komunitetet arabe janë ende në një fazë paraprake të përparimit shkencor. Ata kanë nevojë për një program të shpejtë të rimëkëmbjes me ndryshime radikale. Konfliktet e tanishme në shumë shoqëri lindore nuk janë ideologjike, por më tepër të lidhura me kërkesat e jetës së përditshme dhe detajet sistematike periferike, me dallimet lokale në secilën shoqëri. Progresi dhe zhvillimi kulturor rezultojnë nga kreativiteti intelektual dhe ideologjik, i cili është i kushtëzuar nga revolucionet shkencore brenda strukturës shoqërore.

Kur transmeton shkencë nga një burim i huaj, bota arabe vetëm kopjon korniza intelektuale statike, që i çmon më shumë se novatorët e saj. Psikologjia në botën arabe është individuale në thelb. Megjithatë, psikologjia amerikane, nga e cila ne kemi kopjuar mjaft, e ka tejkaluar këtë fazë në një fazë të re, të karakterizuar nga një theks social dhe historik. Logjikisht, psikologjia duhet të zhvillohet në vendet importuese, sepse kjo kërkon një shkallë të konsiderueshme modifikimi dhe riformulimi për t'u përballuar me mjedisin e ri social, por nuk është kështu. Problemi i kombinuar i respektimit të një objektiviteti empirik të shenjtë dhe rënia e ideologjisë ka rezultuar në ndërprerjen e lëvizjes shkencore në botën arabe dhe në Botën e Tretë sot.

Alternativa e shpresës është një perspektivë dinamike dhe përpjekje serioze për ndryshim, e paraqitur si një grup veprash mendore radikale që mund të çojnë në një zgjidhje të pranueshme dhe të përshtatshme. Kjo mund të arrihej aty ku bota arabe do ta rriste gjendjen aktuale të adoleshencës shkencore dhe intelektuale dhe fanatizmit kulturor; do të zhvillonte konceptet dhe metodat e veta dhe do t'i përdorte ato në mënyrë elastike për metodat dhe qasjet teorike; do të dëshmonte revolucionin e vet shkencor, nëpërmjet gjetjeve dhe zbulimeve të reja në teori, metodë dhe mendim, të parashikonte plotësisht perspektivën e re shkencore dhe një ideologji zëvendësuese, e cila do të çonte në një shtet alternativ kulturor dhe një fazë të re kulturore.



## KAPITULLI V

### ANËSIA NË KURRIKULA DHE PËRMBAJTJE TË LËNDËVE

*Hoda Hegazy*

Institucionet arsimore konsiderohen si mjedisi kryesor për transmetimin e një tradite kulturore. Institucionet e tilla duhet të zgjedhin nga një sasi e pafund e të dhënave dhe ideve dhe të përcaktojnë për studentët një sërë vlerash që shoqëria në përgjithësi i ka adoptuar. Kjo çështje ngre një problem metodologjik: përzgjedhja nga trupi i njohurive e një numri të kufizuar lëndësh që nxënësit duhet t'i mësojnë, pastaj të vendosin për përmbajtjen e duhur që duhet të mësohet në faza të ndryshme arsimore. Kurrikula zakonisht formulohet dhe përcaktohet bazuar në faktorë të tillë si ideologjia mbizotëruese e shoqërisë, filozofia arsimore, sistemi i vlerave dhe koncepti i natyrës njerëzore. Zhvillimi i një kurrikule kërkon një proces përfshirjeje dhe përjashtimi.

Tekstet shkollore pra, nuk janë “neutrale” ose “objektive” dhe pasqyrojnë vlerat dhe besimet e shoqërive të tyre. Prandaj

ne duhet të përcaktojmë paradigmen epistemologjike që bazohet në kurrikulën kur lëndët përgatiten për mësimdhënie. Kur miratohet një perspektivë apo paradigmë, disa pyetje dhe çështje ngrihen me përjashtim të të tjerave. Nga ana tjetër, kur merren me një qasje krahasuese, vetëm tërësitë e plota mund t'i nënshtrohen krahasimeve, në vend të dy sistemeve ose strukturave të ndryshme.

Për shembull, punimi i Max Weber-it: *“Etika Protestante dhe Shpirti i Kapitalizmit”* i drejtohet asaj që ai e konsideroi fenomenin specifik perëndimor të racionalizimit. Kapitalizmi perëndimor, nëse pranojmë pikëpamjen weberiane, është specifik për qytetërimin perëndimor. Ishte e përshtatshme që Weber ta përdorte kapitalizmin perëndimor për ta eksploruar më tej kulturën e tij, por përdorimi i kushteve të njëjta për të eksploruar natyrën specifike të një kulture tjetër është mashtrues.

